



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Në mbështetje të nenit 17 shkronja r) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në zbatim të nenit 2.3 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal nenit 37 paragrafi 1.18, nenit 38 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Arsime dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në mbledhjen e mbajtur me 29.11.2016, merr:

V E N D I M

Për financimin e Manifestimit Mbarëkombëtarë “Flaka e Janarit” 2017

1. Me këtë vendim ndahen mjete financiare në lartësi prej 40,00.00€ për financimin e aktiviteteve të Manifestimit Mbarëkombëtar “Flaka e Janarit” 2017
2. Shuma e mjeteve si në pikën 1 të këtij vendimi do të shfrytëzohen sipas Projekt propozimit për financimin e Manifestimit Mbarëkombëtarë “Flaka e Janarit “ 2017, i cili projekt është pjesë e këtij vendimi.
3. Mjetet financiare ndahen nga Buxheti i Komunës së Gjiçanit-Njësia për Kulturë, Rini dhe Sport,.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset ekzekutivi i Komunës, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesja e KK-Gjiçan.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës,

01.Nr. 016-117687
Gjiçan, më 29.11.2016

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi